

EPPC Albania kërkon një **Retail Store Manager**, për klientin e saj, kompani që operon në fushën e argjendarisë dhe krijimeve artistike.

Përgjegjësitë kryesore:

- Të zhvillojë strategjinë e përgjithshme të shitjes në përputhje me objektivat e biznesit;
- Të hartojë buxhetin vjetor të shitjeve si dhe të kryej ndjekjen e tij deri në realizim;
- Të përgatisë politikën e çmimeve në përputhje me zhvillimin e tregut, projektit dhe kërkesave të kompanisë;
- Të prezantojë në mënyrë dinjitoze produktet dhe shërbimet e kompanisë;
- Të përgatisë periodikisht raportet mbi shitjet dhe rezervimet;
- Të përgatis plane veprimi dhe tabela për të identifikuar klientë të rinj dhe të planifikojë mënyrën për qasje ndaj kontakteve të reja duke analizuar paraprakisht potencialin e blerësit;
- Të përgatisë analiza të tregut, të konkurrencës, të çmimeve, të kënaqësisë së klientit në bashkëpunim me Departamentin e Marketingut;
- Të udhëheq kërkimet në treg për të identifikuar kërkesat e tregut dhe blerësit potencial;
- Të propozojë dhe përgatisë oferta të personalizuar për klientët;
- Të kryej takime periodike për të monitoruar ecurinë dhe problematikat e shitjeve;
- Të raportoj tek eprorët periodikisht zhvillime specifike, informacione të mbledhura në terren,
- Të kryej hedhjen në sistem dhe rakordimin e faturave;
- Të trajtojë stafin e shitjes sipas udhëzimeve, të monitorojë performancën individuale si edhe të grupit në tërësi;
- Kryerja sistematike e inventarit në përgjithësi, suport me sistemimet në magazinë dhe në vitrinat e dyqanit.

Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Diplomë Universitare në Administrim Biznesi, ose degë të tjera të ngjashme;
- Eksperiencë e mëparshme pune në shitje produktesh në sektorin e argjendarisë dhe aksesorëve;
- Njohuri shumë të mira të programeve Microsoft Office, e preferueshme eksperiencë në programin financiarë Alpha;
- Eksperiencë në shërbimin me klientet dhe praktikave bazë të biznesit;
- Njohës i gjuhës angleze;
- Të zotëroj aftësi shumë të mira negociuese, bindese dhe të mbylli shitjet me sukses;
- Të jetë pozitiv, entuziast, i matur, i besueshëm dhe profesional.

Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj në linkun që vijon:

<https://aplikim.eppc.al>

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj do të kualifikohet.